

Drejtuar:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit të Universitetit të Tetovës, dhe Senatit të Universitetit të Tetovës

REFERAT

PËR ZGJEDHJEN-RIZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN: MIKROBIOLOGJIA DHE IMUNOLOGJIA, SIGURIA E USHQIMIT DHE SHËNDETI PUBLIK VETERINAR (4.03.00.05, 4.03.00.22 SIPAS KLASIFIKIMIT TË SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORE-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT).

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e R.M.V-së” nr. 82/18, 178/21 dhe 58/24), nenit 158 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, të shpallur më 31.01.2026 në gazetatat ditore “Koha” dhe “Sllloboden pečat” si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës ë 02.02.2026, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, në mbledhjen e mbajtur më 16.02.2026, solli Vendim për formimin e Komisionit Recensues (Vendimi nr. 21-28/1), në këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Bizena **BIJO**, profesor ordinar, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor I Tiranës, Tiranë – kryetar
2. Prof. Dr. Fatmira **SHEHU** Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë – anëtar
3. Prof. Dr. Mije **REÇI** profesor ordinar, FSHMN, Universiteti i Tetovës, Tetovë – anëtar

Në konkursin e lartpërmendur ka aplikuar vetëm kandidati Prof.Dr. Ismail Ferati, mësimdhënës aktual në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – Universiteti i Tetovës. Dokumentacionin e kompletuar, të paraparë sipas kushteve të konkursit, kandidati e ka dorëzuar me datë 06.02.2026. Komisi oni Recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, paraqet këtë:

R A P O R T

I. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE FORMIMI AKADEMIK

Prof. Dr. Ismail Ferati ka lindur më 05.11.1978 në Zherovjan, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Studimet universitare i ka përfunduar në periudhën 1997–2002 në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Republika e Shqipërisë, ku ka fituar titullin Doktor i Mjekësisë Veterinare (DVM).

Në periudhën 2009–2013 ka ndjekur studimet e doktoratës në Shkollën e Doktoratës, Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Me datë 04.07.2013 ka mbrojtur me sukses disertacionin e doktoratës me titull: “Vlerësimi mikrobiologjik i djathit tradicional të Sharrit i prodhuar në kushte tradicionale dhe industriale”, duke fituar gradën shkencore Doktor i Shkencave në fushën e Mjekësisë Veterinar.

Prof. Dr. Ismail Ferati aktualisht mban titullin Profesor Inordinar në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Universiteti i Tetovës, në lëmin e Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Sigurisë së Ushqimit, dhe është kandidat për zgjedhje në titullin Profesor Ordinar.

Ai posedon mbi dy dekada përvojë akademike, kërkimore dhe laboratorike në fushën e mikrobiologjisë ushqimore, sigurisë së ushqimit, produkteve të qumështit, mikotoksinave, OMGJ-ve, sistemeve HACCP dhe standardeve ISO. Veprimtaria e tij akademike karakterizohet nga progres i vazhdueshëm profesional, angazhim aktiv në procesin mësimor universitar, aktivitetet i zgjeruar shkencor dhe përfshirje e drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe akreditimin e laboratorëve sipas standardit ISO/IEC 17025.

Në periudhën 2002–2007 ka ushtruar profesionin e mjekut veterinar në fushën e preventivës dhe trajtimit të sëmundjeve infektive.

Nga viti 2007 është i punësuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, ku është angazhuar si asistent në realizimin e procesit mësimor.

Në vitin 2016 është zgjedhur në thirrjen Docent për lëndët Mikrobiologjia e Përgjithshme dhe Mikrobiologjia Ushqimore.

Në vitin 2021 është zgjedhur në thirrjen Profesor Inordinar në të njëjtin lëmi shkencor (Mikrobiologjia e Përgjithshme dhe Mikrobiologjia Ushqimore), duke dëshmuar progres të qëndrueshëm në veprimtarinë mësimore-shkencore.

Nga viti 2018 ka ushtruar detyrën e Shefit të Laboratorit në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve laboratorike dhe në procesin e akreditimit sipas standardit ISO/IEC 17025:2018.

Në periudhën 2011–2012 ka ushtruar funksionin e Koordinatorit të ECTS.

Në periudhën 2016–2020 ka qenë Profesor i Ftuar në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë në Prishtinë, në programet e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë.

II. VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

A. Mbajtja e mësimit në ciklin e parë të studimeve

Kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati**, në pesë vitet e fundit, ka realizuar veprimtari të rregullt mësimore në ciklin e parë të studimeve në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit.

Në këtë periudhë ka mbajtur ligjërata në këto lëndë:

- Mikrobiologjia e Përgjithshme
- Mikrobiologjia Ushqimore
- Legjislacioni Ushqimor
- Enzimologjia Ushqimore

Ligjëratat janë zhvilluar në përputhje me programet studimore të akredituara, duke integruar literaturë bashkëkohore shkencore dhe përvojë praktike laboratorike. Kandidati ka përgatitur materiale mësimore të strukturuar dhe të përditësuara për secilën lëndë.

B. Mbajtja e mësimit në ciklin e dytë të studimeve

Në ciklin e dytë të studimeve, kandidati ka mbajtur ligjërata në këto lëndë:

- Komponenten aktiv biologjik dhe mekanizmat e veprimit
- Epidemiologjia e të ushqyerit

- Probiotikët dhe kulturat starter
- Rregulloret ligjore të ushqimit

Në këtë cikël, ligjëratat janë orientuar drejt analizës së avancuar shkencore, duke përfshirë literaturë ndërkombëtare, publikime të fundit shkencore dhe aplikime praktike në fushën e sigurisë ushqimore dhe mikrobiologjisë.

C. Libra universitarë dhe materiale mësimore

Prof. Dr. Ismail Ferati është autor dhe bashkautor i katër (4) librave universitarë nga fusha e mikrobiologjisë, sigurisë ushqimore, teknologjisë dhe imunologjië, të cilët përdoren në procesin mësimor si literaturë bazë dhe plotësuese.

Gjithashtu, kandidati ka përgatitur skripta interne dhe materiale mësimore për secilën nga lëndët që ligjëron, të cilat shërbejnë si mbështetje didaktike për studentët e ciklit të parë dhe të dytë.

D. Mentorime dhe angazhim akademik

Krahas procesit të rregullt mësimor, kandidati ka zhvilluar rregullisht konsultime me studentët dhe ka udhëhequr një numër të konsiderueshëm të punimeve të diplomës dhe masterit, si mentor, komentor ose anëtar i komisioneve për vlerësimin e punimeve.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati nga veprimtaria edukative-mësimore ka realizuar gjithsej **71.8** pikë nga veprimtaria edukative-mësimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE–HULUMTUESE

Krahas angazhimit të rregullt në procesin mësimor, kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka zhvilluar një veprimtari të qëndrueshme dhe të intensifikuar kërkimore-shkencore në fushën e mikrobiologjisë ushqimore, sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, epidemiologjisë ushqimore, analizave laboratorike mikrobiologjike dhe molekulare, si dhe monitorimit të parametrave fiziko-kimikë dhe biologjikë në produkte ushqimore dhe ujë të pijshëm.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përfshin publikime në revista shkencore ndërkombëtare me recension, pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, mentorime në studime pasuniversitare, si dhe angazhim aktiv në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

A. Artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare (2021–2026)

Në periudhën 2021–2026 kandidati ka publikuar gjithsej 13 punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, si vijon:

1. Ferati, I. et al., *The Effect of Environmental Factors on the Microbiological Quality of Flours*, International Journal of Food Technology and Nutrition – Original scientific paper.
2. Xhabiri, G. et al., Ferati, I., *Body Mass Index and Nutritional Habits of Adolescents in the City of Gostivar*, International Journal of Food Technology and Nutrition – Original scientific paper.
3. Durmishi, N. et al., Ferati, I., *Comparison of Some Quality and Microbiological Safety Parameters in Peach Juice with Different Fruit Contents*, International Journal of Food Technology and Nutrition – Professional paper.
4. Ferati, I. et al., *Monitoring of Aflatoxin M1 in Fresh Milk During the Winter Season in the Pollog Region*, Albanian Journal of Agricultural Sciences, 2023.
5. Durmishi, N. et al., Ferati, I., *Monitoring of Some Parameters of Quality and Microbiological Safety in Drinking Water*, International Journal of Food Technology and Nutrition, 2023.
6. Xhabiri, G. et al., Ferati, I., *Investigation the Impact of Local Bean Flour on the Nutritional and Sensory Properties of Biscuits*, International Journal of Food Technology and Nutrition, 2023.
7. Elezi, M. et al., Ferati, I., *Obesity and Modern Chronic Disease Research*, International Journal of Food Technology and Nutrition, 2023.
8. Elezi, M. et al., Ferati, I., *Examination of the Dynamics of Analyses Performed for the Presence of Radionuclide Residues in Food in the Period 2019–2023 in the Republic of North Macedonia*, International Journal of Food Technology and Nutrition – Original scientific paper.
9. Reçi, M. et al., Ferati, I., *Prevalence of SARS-CoV-2 IgG/IgM Antibodies Among Patients in the Tetovo Region*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT – Professional paper.

10. Reçi, M., Ferati, I., Miftari, H., *Serological Prevalence of the Coxiella burnetii Infection in Humans in the Age Group of 0–20 Years in Some Regions of North Macedonia*, BIOLOGIJA, 2024, Vol. 70(4), 219–228.
11. Miftari, H. et al., Ferati, I., *Seasonal Variations in Sensory Characteristics of Traditional White Brined Goat Cheese*, International Journal of Food Technology and Nutrition.
12. Ritovka, N. et al., Ferati, I., *Molecular Diagnostics of COVID-19 in Selection Regions in North Macedonia*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT.
13. Ferati, I. et al., *Advanced Statistical Analysis of the Development Tendency of Mortality from Malignant Neoplasms and the Lifestyle of Patients in R.N. Macedonia*, Proceedings of UBT International Conference, 2024.

B. Mentorime

- Mentor i tre punimeve të magistraturës.

C. Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

Kandidati ka qenë i angazhuar në aplikimin dhe implementimin e projekteve të mëposhtme:

1. “Production Capacity Enhancement and Cost Reduction Plan”, FrigoTeknika Bei, EU4EG, financuar nga Banka Evropiane dhe menaxhuar nga GIZ North Macedonia (2023–2024).
2. “Automation of Egg Grading and Packaging Line”, DSPT Vezë Sharri DOO, EU4EG (2023–2024).
3. “Energy Efficiency of Cooling Systems and Poultry Slaughter Waste Management”, EU4EG (2023–2024).
4. Projekt me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për investime kapitale në pajisje laboratorike për analizat e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit (2024–2025).

D. Pjesëmarrje në konferenca shkencore

Në periudhën 2021–2026 kandidati ka marrë pjesë aktive në konferenca shkencore ndërkombëtare me gjithsej 7 prezantime shkencore.

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues konstaton se kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** në periudhën 2021–2026 ka realizuar veprimtari të qëndrueshme dhe të intensifikuara shkencore-hulumtuese, me publikime të rregullta në revista shkencore ndërkombëtare dhe me angazhim të konsiderueshëm në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, kandidati nga veprimtaria shkencore-hulumtuese ka realizuar gjithsej **83**, duke e tejkaluar numrin minimal të pikëve të parapara për zgjedhjen në thirrjen Profesor Ordinar.

IV. VEPRIMTARIA PROFESIONALE–APLIKATIVE

Krahas veprimtarisë edukative dhe shkencore-hulumtuese, kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm profesional-aplikativ në fushën e sigurisë ushqimore, analizave laboratorike, sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe standardeve ndërkombëtare.

Angazhimi profesional i kandidatit përfshin ekspertiza profesionale, implementim sistemesh të sigurisë ushqimore, validim dhe integrim metodash laboratorike, si dhe drejtim të strukturave laboratorike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Veprimtaria profesionale-aplikative paraqitet si vijon:

A. Ekspertiza dhe mendime profesionale

1. Mendim profesional lidhur me stabilitetin e serotipit *Salmonella enterica* dhe vlerësimin e rrezikut për sigurinë ushqimore, Universiteti i Tetovës, qershor 2025.
2. Konsulent ekspert për analiza mikrobiologjike, cilësore dhe të sigurisë ushqimore të produkteve të kafesë (kontratë për shërbime profesionale), Shkup, maj 2025.

B. Implementimi i sistemeve të sigurisë ushqimore

3. Implementimi i sistemeve HACCP në subjekte të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit (5 raste).
4. Implementimi i sistemeve HALAL në subjekte të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit (2 raste).
5. Realizimi i auditimeve të brendshme dhe të jashtme të sistemeve të sigurisë ushqimore (HACCP dhe sisteme të bazuara në standardet ISO).

C. Ngritja dhe modernizimi i kapaciteteve laboratorike

6. Integrim dhe validim i metodës automatike të identifikimit mikrobiologjik me sistemin **VITEK® 2 Compact**, në fazën përgatitore për akreditimin e laboratorit sipas ISO/IEC 17025.
7. Implementim i metodës për përcaktimin e numrit të qelizave somatike (SCC) me sistemin **NucleoCounter® SCC-400**, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve laboratorike dhe përgatitjes për akreditim sipas ISO/IEC 17025.
8. Aplikim dhe validim i metodës fluorimetrike për përcaktimin e Aflatoksinës M1 (AFM1) në qumësht të papërpunuar duke përdorur sistemin **VICAM 4EX**, në fazën përgatitore për akreditim sipas ISO/IEC 17025.
9. Implementim i metodave imuno-enzimatike (ELFA) për detektim mikrobiologjik dhe toksinologjik me sistemin **miniVIDAS® Blue**, në kuadër të modernizimit të kapaciteteve laboratorike.
10. Implementim i metodave spektroskopike në infra të kuqe (NIR) për vlerësimin e parametrave të cilësisë dhe përbërjes së produkteve ushqimore me sistemin **Finder® SD**.

D. Funksione drejtuese

1. Shef i laboratorit, me përgjegjësi për menaxhimin teknik, organizativ dhe profesional të aktiviteteve laboratorike në përputhje me standardet ISO dhe kërkesat e akreditimit.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues konstaton se kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka zhvilluar veprimtari të konsiderueshme profesionale-aplikative në fushën e sigurisë ushqimore, implementimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve laboratorike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, kandidati nga veprimtaria profesionale-aplikative ka realizuar gjithsej **16 pikë**.

V. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

A. Angazhim në organe dhe komitete shkencore

Kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka qenë i angazhuar në struktura shkencore dhe institucionale me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, si:

1. Anëtar i Komitetit Shkencor Ndërkombëtar në Konferencën e Parë Ndërkombëtare Shkencore “Food Science, Nutrition, Innovative Technologies and Sustainability”, Universiteti “St. Kliment Ohridski” – Manastir, 03 Tetor 2025.
2. Anëtar i Këshillit në Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Anëtar i grupit punues për përgatitjen e Ligjit për Produkte Bujqësore Organike (2021), duke kontribuar në zhvillimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurisë dhe prodhimit organik.

B. Pjesëmarrje dhe kontribut në tubime shkencore dhe profesionale

1. Prezantim shkencor në Konferencën e organizuar nga Oda e Veterinerëve të Kosovës, Prizren, 2025, me temën: “Aflatoksina M1 në qumësht – roli i Aflatoksinës B1 në ushqimin e lopëve qumështore dhe implikimet për shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore”.
2. Panelist në kuadër të projektit EU4EG, organizuar nga GIZ Maqedonia e Veriut, me temën:
“Sfidat gjatë procesit të konceptimit dhe implementimit të projekteve në Rajonin e Pollogut si BSO Pollog Region”.

C. Funksione akademike dhe kontribut institucional

1. Koordinator i procesit të akreditimit të laboratorit sipas standardit ISO/IEC 17025:2018 (29.07.2024), duke udhëhequr procesin e ngritjes dhe formalizimit të kapaciteteve laboratorike të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit.
2. Profesor vizitor në University of Business and Technology, Prishtinë (2016–2020).
3. ECTS Coordinator në Universitetin e Tetovës (2011–2012).
4. Organizim dhe ligjërime në “International Summer Academy on Safe Sustainable Food from Field to Table” (2018, 2019).

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka realizuar: **10 pikë** nga veprimtaritë me interes më të gjerë në periudhën pas zgjedhjes së fundit (2021–2025), duke përmbushur dhe tejkaluar kriterin minimal të përcaktuar për zgjedhje në thirrjen Profesor Ordinar.

VI. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORESHKENCORE

Në shtojcë e bashkëngjisim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka gjithsej **180.8 pikë**, edhe atë për: veprimtarinë edukative-mësimore – **71.8 pikë**, veprimtarinë kërkimore - shkencore – **83 pikë**, veprimtaria profesionale aplikative - **16** dhe veprimtaritë me interes më të gjerë – **10 pikë**.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË TITULL	Pikë
VEPRIMTARIA ARSIMORE	71.8
VEPRIMTARIA KËRKIMORE - SHKENCORE	83
VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE	16
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË	10
Gjithsej	180.8

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të analizës së veprimtarisë edukative-mësimore, shkencore-hulumtuese dhe të aktiviteteve me interes më të gjerë, Komisioni konstaton se kandidati **Prof. Dr. Ismail Ferati** ka përmbushur dhe tejkaluar kriteret e përcaktuara me Rregulloren për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, duke tubuar **gjithsej 180.8 pikë** nga referencat profesionale.

Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se kandidati ka dëshmuar cilësi dhe vazhdimësi në procesin mësimor, kontribut të rëndësishëm në kërkimin shkencor dhe angazhim në zhvillimin e kapaciteteve laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik veterinar.

Duke u bazuar në përmbushjen e të gjitha kriterëve ligjore dhe akademike, Komisioni recensues i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Senatit të Universitetit të Tetovës që Prof. Dr. Ismail Ferati të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Ordinar** në lëmin: Mikrobiologjia dhe imunologjia, siguria e ushqimit dhe shëndeti publik veterinar (4.03.00.05, 4.03.00.22 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, 06.03.2026

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof. Dr. Bizena **BIJO**, profesor ordinar – Kryetar

2. Prof. Dr. Fatmira **SHEHU**, profesor ordinar – Anëtar

3. Prof. Dr. Mije **REÇI**, profesor ordinar – Anëtar

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULL MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR

Kandidati:

Ismail Jahja Ferati

(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni:

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Universiteti I Tetovës

Fusha shkencore:

Fusha shkencore – **Shkencat Bioteknike (4.03.00)**, lëmi – **Mikrobiologjia dhe Imunologjia (4.03.00.05)** dhe **Siguria e Ushqimit dhe Shëndeti Publik Veterinar (4.03.00.22)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULL MËSIMOR- SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR/ TITULL SHKENCOR – KËSHILLTAR SHKENCOR

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve (po/jo)
1	Suksesi mesatar prej së paku 8.00 në studimet e integruara. Suksesi mesatar për studimet e integruara: 9.032	po
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet. Emri i sferës shkencore: Shkencat Bioteknike Fusha: Mikrobiologjia dhe Imunologjia Dega: Siguria e Ushqimit dhe Shëndeti Publik Veterinar	po
3	Të ketë të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të	jo

	revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar për arsimin e lartë 1. Emri i revistës shkencore: _____ 2. Emri i bazës elektronike të revistave: _____ 3. Titulli i punimit: _____ 4. Data e publikimit: _____	
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. 1. Emri i revistës shkencore: _____ 2. Titulli i punimit: _____ 3. Data e publikimit: _____	Po
3.2.1	International Journal of Food Technology and Nutrition Titulli i punimit: <i>The Effect of Environmental Factors on the Microbiological Quality of Flours</i>; UDC: 664.641:579.67 Original scientific paper Data e publikimit: 2022	Po
3.2.2	Albanian Journal of Agricultural Sciences, 2023 Titulli i punimit: Monitoring of Aflatoxin M1 in Fresh Milk During the Winter Season in the Pollog Region Data e publikimit: 2023	Po
3.2.3	Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT Titulli i punimit: Prevalence of SARS-CoV-2 IgG/IgM Antibodies Among Patients in the Tetovo Region, North Macedonia Data e publikimit: 2024	Po
3.24	Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT Titulli i punimit: <i>Molecular Diagnostics of COVID-19 in Selection Regions</i>	Po

	<i>in North Macedonia</i> Data e publikimit: 2025	
3.2.5	International Journal of Food Technology and Nutrition Titulli i punimit: Monitoring of Some Parameters of Quality and Microbiological Safety in Drinking Water Data e publikimit: 2023	Po
3.3	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe e cila është e publikuar në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian/ose OBZHE 1. Titulli i revistës shkencore: BIOLOGIJA 2. Emri i shtetit anëtar i BE/OBZHE: Lituani (Bashkimi Evropian) 3. Titulli i punimit: Serological prevalence of the Coxiella burnetii infection in humans in the age group of 0–20 years in some regions of North Macedonia Data e publikimit: 16.12.2024	Po
4.	Libër mësimor i recensuar dhe i publikuar, monografi, praktikum ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet 1. Titulli i librit mësimor: Imunologjia – Libër universitar Autorë: Mije Reçi dhe Ismail Ferati 2. Vendi dhe data e botimit: Arbëria Design, Tetovë, 2024	Po
5.	Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimor-shkencor – profesor i asociuar, data dhe numri i Buletinit: Vendimi numër 21-156/1 me datë 21.06.2021, Buletini numër 188.	Po
6.	Posedon aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: 1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: Universiteti i Tetovës (RMV), Universiteti Bujqësor i Tiranës (Shqipëri). 2. Lloji i trajnimit/ përvoja/ arsimimi për fitimin e aftësive dhe	Po

	shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: Studime deridiplomike dhe postdiplomike (doktoruar në vitin 2013), përvojë shumëvjeçare në procesin mësimor si asistent (nga viti 2007), docent (nga viti 2016), profesor i asociuar (nga viti 2021), veprimtari kërkimore-shkencore dhe mentorim. 3. Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: shtatëmbëdhjetëvjeçare (2007 – vazhdon).	
--	---	--

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË- SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Ismail Jahja Ferati

(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni:

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Universiteti I Tetovës

Fusha shkencore:

Fusha shkencore – **Shkencat Bioteknike (4.03.00)**, lëmi – **Mikrobiologjia dhe Imunologjia (4.03.00.05)** dhe Siguria e Ushqimit dhe Shëndeti Publik Veterinar (4.03.00.22)

I. VEPRIMTARIA EDUKATIVE ARSIMORE

Nr.	Aktiviteti	Kalkulimi	Pikë
A. Mbajtja e ligjëratave – Cikli I			
1	Mikrobiologjia e Përgjithshme – Teknologji ushqimore	3×15×0.04	1.8
2	Mikrobiologjia e Përgjithshme – Teknologji ushqimore	3×15×0.04	1.8
3	Mikrobiologjia ushqimore – Menaxhim	3×15×0.04	1.8
4	Mikrobiologjia Ushqimore – Teknologji ushqimore	3×15×0.04	1.8
5	Mikrobiologjia Ushqimore – Nutricion	3×15×0.04	1.8
6	Mikrobiologjia Ushqimore – Menaxhim	3×15×0.04	1.8
7	Enzimologjia Ushqimore - Teknologji ushqimore	2×15×0.04	1.2
8	Legjislacioni Ushqimor	3×15×0.04	1.8
B. Ushtrime – Cikli I			
9	Legjislacioni Ushqimor	2×15×0.03	0.9
10	Mikrobiologjia e Përgjithshme	2×15×0.03	0.9
C. Lëndë të reja – Cikli I			
11	Enzimologjia Ushqimore (L)	1×1	1
12	Legjislacioni Ushqimor (L)	1×1	1
13	Legjislacioni Ushqimor (U)	1×0.5	0.5
D. Mbajtja e ligjëratave – Cikli II			
14	Epidemiologjia e të Ushqyerit – Nutricion	3×15×0.05	2.25
15	Komponentët aktive biologjike në ushqim dhe mekanizmat e veprimit	2×15×0.05	1.5
16	Probiotikët dhe kulturat starter	2×15×0.05	1.5
17	Rregulloret ligjore të ushqimit	3×15×0.05	2.25
E. Lëndë të reja – Cikli II			
18	Epidemiologjia e të Ushqyerit – Nutricion (L)	1×1	1
19	Komponentët aktive biologjike në ushqim dhe mekanizmat e veprimit (L)	1×1	1
20	Probiotikët dhe kulturat starter (L)	1×1	1
21	Rregulloret ligjore të ushqimit (L)	1×1	1

F. Konsultime me studentë – Cikli I			
22	Mikrobiologjia e Përgjithshme – Teknologji ushqimore	20×0.002	0.04
23	Mikrobiologjia e Përgjithshme – Nutricion	8×0.002	0.016
24	Mikrobiologjia Ushqimore – Menaxhim	10×0.002	0.02
25	Mikrobiologjia Ushqimore – Teknologji ushqimore	18×0.002	0.036
26	Mikrobiologjia Ushqimore – Nutricion	6×0.002	0.012
27	Mikrobiologjia Ushqimore – Menaxhim	15×0.002	0.03
28	Enzimologjia Ushqimore - Teknologji ushqimore	15×0.002	0.03
29	Legjislacioni Ushqimor	8×0.002	0.016
G. Skripte interne të ligjëratave			
30	Mikrobiologjia e Përgjithshme	1×4	4
31	Mikrobiologjia Ushqimore	1×4	4
32	Enzimologjia Ushqimore	1×4	4
33	Probiotikët dhe kulturat starter	1×4	4
34	Rregulloret ligjore të ushqimit	1×4	4
35	Epidemiologjia e të Ushqyerit – Nutricion	1×4	4
36	Legjislacioni Ushqimor	1×4	4
H. Mentorime dhe komisione			
37	Mentor i diplomave	10×0.2	2
38	Anëtar komisioni – Magjistraturë	5×0.3	1.5
39	Anëtar komisioni – Diplomë	10×0.2	2
40	Anëtar komisioni – Doktoratë	1×0.5	0.5
I. Libër universitar			
41	Imunologjia, UT, 2024	1×8	8
Gjithsej			71.8

II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE–SHKENCORE

A. Aktivitetet kërkimore dhe projekte

Nr.	Emri i aktivitetit	Institucioni / Programi	Kalkulimi	Pikë
1	Mentor i punimit të magjistraturës	Universiteti i Tetovës	3×1	3
2	Aplikimi dhe implementimi i projektit Application and implementation of the project “Production Capacity Enhancement and Cost Reduction Plan”, FrigoTeknika Bei, EU for Economic Growth (EU4EG), financed by the European Bank and managed by GIZ North Macedonia (2023–2024)	EU4EG – GIZ North Macedonia	1×9	9
3	Application and implementation of the project “Automation of Egg Grading and Packaging Line”, DSPT Vezë Sharri DOO, financed by the European Bank and managed by GIZ North Macedonia (2023–2024)	EU4EG – GIZ North Macedonia	1×9	9
4	Application and implementation of the project “Energy Efficiency of Cooling Systems and Poultry Slaughter Waste Management”, financed by the European Bank and managed by GIZ North Macedonia (2023–2024)	EU4EG – GIZ North Macedonia	1×9	9
5	Aplikimi dhe implementimi i projektit me Ministrinë e	MBPU	1×6	6

	Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Mbështetje financiare në kuadër të masës “Mbështetje Teknike në Bujqësi dhe Zhvillim Rural”, nënmasa 1.6 “Shpenzime investuese për themelimin e shembujve shkencor-demonstrativë”, nga Programi për Mbështetje Financiare të Zhvillimit Rural për vitin 2024 (2024–2025).			
6	Pjesëmarrje me prezantim në konferenca shkencore	7 prezantime	7×1	7
Gjithsej				43

B. Punime shkencore të botuara (2021–2026)

Nr.	Autorët	Titulli	Revista / Botimi	ISSN / UDC	Pikë
1	Ismail Ferati, Tatjana Kalevska, Daniela Nikolovska Nedelkoska, Petya Ivanova, Namik Durmishi, Gafur Xhabiri, Hava Miftari, Durim Alija, Rejhana Luma	The effect of environmental factors on the microbiological quality of flours	International Journal of Food Technology and Nutrition	UDC: 664.641:579.67 Original scientific paper	3
2	Gafur Xhabiri, Ganimete Ramadani Limani, Namik Durmishi, Hava Miftari, Durim Alija, Ismail Ferati	Body mass index and nutritional habits of adolescents in the city of gostivar	International Journal of Food Technology and Nutrition	UDC: 613.2-056.23-053.6(497.752) Original scientific paper	3
3	Namik Durmishi, Ismail Ferati, Gafur Xhabiri, Rejhana Luma, Ljubica Karakasova, Viktorija Stamatovska, Iliana Lazova-Borisova	Comparison of some quality and microbiological safety parameters in peach juice with different fruit contents	International Journal of Food Technology and Nutrition	UDC: 664.856.036.52 3 Professional paper	3
4	Ismail Ferati, Daniela Nikolovska Nedelkoska, Hava Miftari, Mije Reçi, Durim Alija, Rejhana Luma	Monitoring of aflatoxin M1 in fresh milk during the winter season in the Pollog region	Albanian Journal of Agricultural Sciences, 2023;22 (Special Issue): 16–18	ISSN 2218-2020	3
5	Namik Durmishi, Gafur Xhabiri, Ismail Ferati, Durim Alija, Ljubica Karakasov, Viktorija Stamatovska, Iliana Lazova Borisova	Monitoring of some parameters of quality and microbiological safety in drinking water	International Journal of Food Technology and Nutrition	UDC: 628.1.033:579.67(497.)Professi onal paper	3
6	Gafur Xhabiri, Rihan Abdylmani, Adis Velu, Namik Durmishi, Durim Alija, Ismail Ferati	Investigation the impact of local bean flour on the nutritional and sensory properties of biscuits	International journal of food technology and nutrition	Udc: 664.681: [664.2:633.491 professional paper	3

7	Merije Elezi, Mereme Azizi–Idrizi, Gafur Xhabiri, Vlatko Tanevski, Besnik Elezi, Ismail Ferati, Namik Durmishi, Laureta Abazi	Obesity and modern chronic disease research	International journal of food technology and nutrition	Udc: 613.25:572.087.1(497.) Professional paper	3
8	Ismail Ferati, Vlatko Tanevski, Xezair Idrizi, Durim Alija, Reyhana Luma	Advanced Statistical Analysis of The Development Tendency of Mortality From Malignant Neoplasms and the Lifestyle of Patients Sick From Malignant Neoplasms in R. N. Macedonia	UBT International Conference	UBT International Conference. 6. https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2024UBTIC/PNS/	3
9	Merije Elezi, Vlatko Tanevski, Besnik Elezi, Ismail Ferati, Enes Nesimi, Mirsade Tairi, Zuliha Avdija, Enisa Rahmani, Mustafa Mustafi	Examination of the dynamics of analyzes performed for the presence of radionuclide residues in food in the period 2019–2023 in the republic of north macedonia	International journal of food technology and nutrition	Udc: 635.8:539.16(497.7)“2019/2023” 664.641.1:539.16(497.7)“2019/2023” original scientific paper	3
10	Mije Reçi, Beslinda Memeti, Ismail Ferati, Sheval F Memishi	PREVALENCE OF SARS-cov-2 igg/igm ANTIBODIES AMONG PATIENTS IN THE TETOVO REGION, NORTH MACEDONIA	Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT	UDC: 616.98:578.834]- 097(497.751)“2020/2021” Professional paper	3
11	Mije Reçi, Ismail Ferati, Hava Miftari	Serological prevalence of the Coxiella burnetii infection in humans in the age group of 0–20 years in some regions of North Macedonia	BIOLOGIJA, 2024, Vol. 70, No. 4, p. 219–228	ISSN 1392-0146, DOI: 10.6001/biologija.2024.70.4.6	4
12	Hava Miftari, Tatjana Kalevska, Tatjana Blazevska, Ismail Ferati, Daniela Nikolovska Nedelkoska	Seasonal variations in sensory characteristics of traditional white brined goat cheese	International journal of food technology and nutrition	Udc: 637.352'639.05(497.7) professional paper	3
13	Nadica Ritovka, Mije Reçi, Sheval F Memishi, Ismail Ferati, Vlatko	Molecular diagnostics of covid-19 in selection	Journal of natural sciences and mathematics of ut	Udc: 616.98:578.834]-	3

	Tanevski	regions in north macedonia		07:577.2(497.7) "2021/2022" professional paper	
Punime shkencore të botuara (2021–2026)					40
Veprimtaria kërkimore–shkencore gjithsej					83

IV. VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Kalkulimi	Pikë
1.	Mendimit profesional lidhur me stabilitetin e serotipit <i>Salmonella enterica</i> dhe vlerësimin e rrezikut për sigurinë ushqimore, Universiteti i Tetovës, qershor 2025.	1x1	1
2.	Konsulent ekspert për analiza mikrobiologjike, cilësore dhe të sigurisë ushqimore të produkteve të kafesë (kontratë për shërbime profesionale), Shkup, maj 2025	1x1	1
3.	Implementimi i sistemeve HACCP në subjekte të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit	5x1	5
4.	Implementimi i sistemeve HALAL në subjekte të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit	2x1	2
5.	Realizimi i auditimeve të brendshme dhe të jashtme të sistemeve të sigurisë ushqimore (HACCP dhe sisteme të bazuara në standardet ISO)	2x1	1
6.	Integrim dhe validim i metodës automatike të identifikimit mikrobiologjik me sistemin VITEK® 2 Compact gjatë fazës përgatitore për akreditimin e laboratorit sipas ISO/IEC 17025.	1x1	1
7.	Implementim i metodës për përcaktimin e numrit të qelizave somatike (SCC) me sistemin NucleoCounter® SCC-400 në kuadër të ngritjes së kapaciteteve laboratorike dhe përgatitjes për akreditim sipas ISO/IEC 17025.	1x1	1
8.	Aplikim dhe validim i metodës fluorimetrike për përcaktimin e Aflatoksinës M1 (AFM1) në qumësht të papërpunuar duke përdorur sistemin VICAM 4EX, në fazën përgatitore për akreditim sipas ISO/IEC 17025.	1x1	1
9.	Implementim i metodave imuno-enzimatike (ELFA) për detektim mikrobiologjik dhe toksinologjik me sistemin miniVIDAS® Blue në kuadër të modernizimit të kapaciteteve laboratorike..	1x1	1
10.	Implementim i metodave spektroskopike në infra të kuqe	1x1	1

	(NIR) për vlerësimin e parametrave të cilësisë dhe përbërjes së produkteve ushqimore me sistemin Finder® SD.		
11.	Shef i laboratorit	1x1	1
GJITHSEJ			16

V. VEPRIMTARIA E INTERESIT TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit	Kalkulimi	Pikë
1	Anëtar i Komitetit Shkencor Ndërkombëtar – Konferenca “Food Science, Nutrition, Innovative Technologies and Sustainability”, Universiteti “St. Kliment Ohridski” – Manastir, 03.10.2025	1 × 1	1
2	Anëtar i Këshillit në Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	1 × 1	1
3	Udhëheqës i projektit bazë: “Skriningu i GMO dhe reduktimi fermentativ i akrilamidit dhe mikotoksinave...”	1 × 1	1
4	Prezantim: “Aflatoksina M1 në qumësht – roli i AFB1...” – Oda e Veterinerëve të Kosovës, Prizren, 2025	1 × 1	1
5	Panelist – EU4EG / GIZ Maqedonia e Veriut (BSO Pollog Region)	1 × 1	1
6	Anëtar i grupit punues për përgatitjen e Ligjit për Produkte Bujqësore Organike (2021)	1 × 1	1
7	Koordinator i procesit të akreditimit të laboratorit sipas ISO/IEC 17025:2018 (29.07.2024)	1 × 1	1
8	Certifikatë Auditor/Konsulent për standardin HALAL (2024)	1 × 1	1
9	Certified Lead Auditor – ISO 9001/14001/22000/45001/27001 (2025)	1 × 1	1
10	Pjesëmarrje – Waters Users Meeting 2025 (kromatografi & spektrometri masash)	1 × 1	1
Gjithësej			10

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË TITULL	Pikë
VEPRIMTARIA ARSIMORE	71.8
VEPRIMTARIA KËRKIMORE - SHKENCORE	83
VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE	16
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË	10
Gjithsej	180.8

Tetovë, 06.03.2026

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof. Dr. Bizena **BIJO**, profesor ordinar – Kryetar

2. Prof. Dr. Fatmira **SHEHU**, profesor ordinar – Anëtar

3. Prof. Dr. Mije **REÇI**, profesor ordinar – Anëtar
